



STATUTI I SHOQËRISË  
"BOBO FARM" shpk

**KREU I**  
**THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SË**  
**INTERNETIT**

Neni 1

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Bobo Farm shpk është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e themeluar në përputhje të plotë me Ligjin Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore dhe që funksionon në përputhje me dispozitat e këtij Statuti.
2. Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është "BOBO FARM" shpk.
3. Ortak i vetëm i "Bobo Farm" shpk është:
  - Erjon NEXHIPI, i biri i Ramadanit dhe i Luljetës, me datëlindje 04.03.1978, lindur dhe banues në Korçë, adresa Rr. Kiço Greço, Lagjia nr. 9, posedues i ID shqiptar me Nr. H80304114S, Nr. Cel: +355672000038, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

Neni 2

**Objekti**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Zhvillimi i aktivitetit në bujqësi, blegtori, pemtari, akua-kulturë, makineri bujqësore, ruajtje dhe frigoriferim, paketim, bletari, bimë medicinale, agroturizëm, hoteleri, design, prodhim, transport, shërbim bar-restorant, agropërpunim, projektim, ndërtim etj.
- Veprimtari formimi dhe konsulence, kërkimi marketing, dhe pune të tjera kërkimore-shkencore që kanë të bëjnë me të gjitha punimet dhe shërbimet realizimi i të cilave është i përfshirë në objektin e shoqërisë. Import-eksport të produkteve të çdo lloji dhe tipi. Shitje-blerje e të mirave si dhe menaxhimi i tyre nëpërmjet vendodhjes ku ato janë.
- Çdo aktivitet tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi në Republikën e Shqipërisë

Neni 3

**Kohëzgjatja**

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar do të kryejë aktivitet tregtar për një afat të pacaktuar.

Neni 4

**Selia, Adresa e faqes së internetit dhe Adresa Elektronike**

1. Selia e Shoqërisë do të jetë në Korçë, në adresën: Rr. "Kiço Greço", Lagjia nr. 9 Nr. 13, Korçë
2. Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë është: [www.bobofarm.al](http://www.bobofarm.al)
3. Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [erjonalb@yahoo.co.uk](mailto:erjonalb@yahoo.co.uk)

## KREU II KAPITALI

### Neni 5 Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë në vlerën 100,000.00 (njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuote  
Kuotat në kapitalin e shoqërisë i zotëron ortakut i vetëm:
- Z. Erjon Nexhipi, lloji i kontributit: **PARA**, numri i kuotave 1 (një) dhe vlera nominale e aksioneve do të jetë 100,000.00 (një qind mijë) Lekë, me një vlerë kontributi: 100,000.00 (një qind mijë) Lekë.

### Neni 6 Regjistri i kuotave

1. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar mban një regjistër të posaçëm, ku regjistrohen të dhënat e zotëruesit/ve të kuotave të shoqërisë, si: emri e mbiemri i ortakut, apo emri i regjistruar, nëse është person juridik, vlera nominale e kuotës, adresa e banimit apo zyra qendrore e ortakut dhe data e kryerjes së regjistrimit.
2. Administratori është përgjegjës për mbajtjen e regjistrimit të kuotave të shoqërisë e detyrohet të lejojë aksesin në informacionet e regjistrimit ndaj çdo ortakut apo çdo personi tjetër që e kërkon. Informacioni i regjistrimit të kuotave duhet të publikohet në faqen e shoqërisë në internet. Shoqëria mund të lejojë regjistrimin *on-line* të të dhënave, që duhen regjistruar sipas pikës 1 të këtij neni.

### Neni 7

#### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



### KREU III ORGANET E SHOQËRISË

#### Neni 8 Organet e shoqërisë

Organet e shoqërisë aksionare janë:

1. Asambleja e Përgjithshme;
2. Administratori/administratorët.

#### Neni 9 Asambleja e Përgjithshme

Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm.

1. Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.



2. Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

3. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

## ADMINISTRATORËT


### Emërimi, shkarkimi, të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Emerohet z. Erjon Nexhipi me afat 5 vjeçar me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Statuti mund të vendosë rregulla të posaçme për emërimin e administratorëve.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;



dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;

e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

#### KREU IV LIKUIDIMI

Neni 11

##### Likuidimi në gjendjen e aftësisë paguese

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese.

Neni 12

##### Baza Ligjore

1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 13

##### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe te tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë.


Hartuar më datë 14.02.2018

---

Asambleja e Përgjithshme

ORTAK I VETËM

Z. Erjon NEXHIPI



(Emër, Mbiemër, Firmë)

